



REPUBLICA KOSOVA REPUBLIKA KOSOVË KOSOVA CUMHURİYETİ
KOMUNA E GJILANIT - ÖSTINA GJILANE - GJILAN BELEDIYE
02 Nr/Brc/No. 1200
Data/Datum/Tarih 10.07.2015
GJILAN - GJILANE - GJILAN



The Municipality of Gjilan (MoGj) Adem Jashari pn. 60000 Gjilan, Kosovo, University "KadriZeka" (UKZ) rr."ZijaShemsiu" pn. 60000 Gjilan, Kosovo and Triones Institute of Technology Not for Profit Ltd. (TlOT) Rétközutca 16. Budapest 1118 Hungary, (hereinafter: Parties), on 10th of July 2015 in Gjilan, sign this:

Co-operation Agreement

To establish and operate the Gjilan Open Source Virtual Economic Zone (GOSVEZ).

Parties express their intent and commitment to establish the following terms and conditions and co-operate with each other as per the Sections laid down below with a view to establishing and running GOSVEZ:

- A) Parties intend to establish a Development Coordination Committee (DCC) to co-ordinate and supervise the required development projects and to guarantee the scholarly standard thereof. Each party will delegate a representative to serve at DCC.
- B) With the aim of developing GOSVEZ, a separate project (Project) will be set up under a special agreement (Project Foundation Document - PFD), which Document will designate a Project Manager (PM), as well.
- C) As per the concept provided by TlOT, Parties intend to develop GOSVEZ through an open source code, which means that anyone registering (Registered Contributor) on GOSVEZ Website by providing his/her authentic personal data shall be authorised to contribute to the Development Project by, putting forward ideas, proposals, solutions, applications, etc. (hereinafter: Initiative) thereby enriching the Project.
- D) Although any and all intellectual properties rendered by Parties or Registered Contributors without any consideration for the good of the Project shall continue to be owned by the provider (Owner), anyone familiarizing himself with such an Initiative or downloading it from GOSVEZ Website shall have an unlimited legal right to take advantage of it;
- E) As a primary forum of their co-operation and with a view to ensuring personal conditions and a common structure for their decision-making, Parties will establish a Steering Committee (SC). SC will be in charge of ensuring optimal overall performance of GOSVEZ.
- F) Parties hereto herewith commit to utilise any funds or subsidies – claimed for GOSVEZ development or obtained with a reference thereto – exclusively for the implementation of the Project;
- G) Parties hereto commit – up to the resources available to them permitting – to have a share in creating the kick-off conditions of the Development Projects.
- H) Parties are ready to have the broadest possible co-operation with any person, organisation and institution that can also identify with the said objectives.

By executing this Agreement, Parties hereto express their conviction that the establishment of GOSVEZ through an open source principle and the spread of the model within broad bands will involve a decisive contribution not only to the social and economic development of Region Gjilan and Kosovo, but also to the integration of the Western Balkans into global social and economic most up to date developments.



Mr. Lutfi Haziri
Mayor of Gjilan

Dr. Károly Nagy
TlOT - Managing Director
Dated 10th of July 2015



Dr. Naim Syla
UKZ - Rector



Komuna e Gjilanit (KGj) *Adem Jashari* pn. 60000 Gjilan, Kosovë, Universiteti "Kadri Zeka" (UKZ) rr."Zija Shemsiu" pn. 60000 Gjilan, Kosovë dhe Organizata Joprofitabile Triones Institute of Technology Ltd. (TIoT) Rétköz utca 16. Budapest 1118 Hungary, (tash e tutje: Palët), me 10 korrik 2015 në Gjilan, nënshkruajnë këtë:

Marrëveshje Bashkëpunimi

Të themelojnë dhe funksionalizojnë Zonën Virtuale Ekonomike me Burime të Hapura të Gjilanit, Angl: the Gjilan Open Source Virtual Economic Zone (GOSVEZ).


Palët shprehin qëllimin dhe përkushtimin e tyre që të krijojnë kushtet dhe të bashkëpunojnë me njëra tjetrën sipas Seksioneve të radhitura më poshtë me synim të themelimit dhe menaxhimit të GOSVEZ:

- A) Palët kanë për qëllim të themelojnë një Komitet për Zhvillim dhe Koordinim (Angl: Development Coordination Committee - DCC) me qëllim të koordinimit dhe mbikëqyrjes së projekteve zhvillimore të nevojshme si dhe të garantojnë një standard akademik. Secila palë do të delegojë një përfaqësues në DCC.
- B) Me synim të zhvillimit të GOSVEZ, një projekt i posaçëm (Projekti) do të themelohet me marrëveshje të veçantë (Marrëveshja për Themelin e Projektit), marrëveshje e cila do të përcaktojë edhe udhëheqësin e projektit.
- C) Duke u bazuar në konceptin e ofruar nga TIoT, Palët kanë për qëllim të zhvillojnë GOSVEZ përmes kodit Burimor të hapur, që nënkupton se cilado palë e regjistruar (Kontribues i Regjistruar) në Faqen e GOSVEZ duke ofruar të dhënat autentike të tyre do të autorizohet që të kontribuojë në Zhvillimin e Projektit duke ofruar ide, propozime, zgjidhje, aplikacione etj. (tash e tutje: Iniciativa) dhe në këtë mënyrë duke e pasuruar Projektin.
- D) Edhe pse cilado pjesë apo gjithë pasuritë intelektuale të krijuara nga Palët apo Kontribuesit e Regjistruar pa ndonjë pasojë për mirëqenien e Projektit do të vazhdojnë të jenë pronë e ofruesit (Pronarit), kushdo që njoftohet me Inicjativat në fjalë dhe që i shkarkon nga faqja e GOSVEZ do të ketë të drejtë të pa kontestuar ligjore që ta shfrytëzojë atë;
- E) Si forum primar për bashkëpunimin e tyre dhe me qëllim që të sigurohen kushtet individuale dhe strukturën e përbashkët për vendim marrje, Palët do të themelojnë një Komitet Drejtues (KD). KD do të jetë i ngarkuar që të siguroj performancë optimale të përgjithshme të GOSVEZ.
- F) Palët marrin përsipër që cilatdo fonde apo subvencione – të mara në emër të zhvillimit të GOSVEZ – ti shfrytëzojnë ekskluzivisht për implementimin e Projektit;
- G) Palët marrin përsipër – deri në nivelin që u lejojnë resurset në dispozicion – që të kontribuojnë në krijimin e kushteve për fillim të Zhvillimit të Projektit.
- H) Palët janë të gatshme që të kenë bashkëpunimin më të gjërë me cilindo person, organizatë dhe institucion që identifikohen me objektivat e lartcekura.

Duke e realizuar këtë Marrëveshje, Palët tash e tutje shprehin vendosmërinë e tyre për të themeluar GOSVEZ përmes parimit të Burimit të Hapur dhe të shpërndajnjë modelin në atë mënyrë që të përfshijë kontribut të theksuar jo vetëm për zhvillimin socio-ekonomik të Rajonit të Gjilanit dhe Kosovës, por edhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në zhvillimet sociale-ekonomike globale më të fundit.



Z. Lutfi Hazmi
Kryetar i Komunës
Gjilan



Dr. Károly Nagy
TIoT - Managing Director

10 korrik 2015



Dr. Naim Syla
UKZ - Rektor